



EDUKIMI MJEDISOR



Janar 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinë studimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnë për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisë qarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumë atë.

"Natyra nuk është thjesht një vend për t'u vizituar.

Ajo është shtëpia jonë."

Gary Snyder

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në 12 AdZM-të e vendit mbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjediseve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehje dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisor nxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor [Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura](#) paraqet aktivitetet e zhvilluara nga [12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura](#), me nxënësit e shkollave të ndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatë muajit [janar 2025](#). Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjen gjeografike.

Nxënës të përfshirë **652**

Specialistë të angazhuar **24**

Orë mjedisore të realizuara **33**

33 Shkolla të përfshira

33 Mësues të përfshirë

“EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



18 janar 2025, numërimi i shpendëve

Në kuadër të aktivitetit për realizimin e Censurit të Shpendëve Ujorë Dimërues, specialistët e ADZM Shkodër në bashkëpunim me ekspertë ornitologë të AOS dhe studentë të degës "Bio-Kimi" të Universitetit "Luigj Gurakuqi", kryen monitorimin në Liqenin e Shkodrës. Ky aktivitet kishte për qëllim njohjen e studentëve me teknikat e realizimit të censurit dhe identifikimin e shpendëve ujorë dimërues. Përmes këtij projekti, studentët u njohën me rëndësinë e monitorimit të biodiversitetit dhe rolin e shpendëve ujorë në ekosistemin e liqenit. Ky proces i angazhimit praktik-shkencor u shoqërua me një përvojë të vlefshme për pjesëmarrësit.

22 janar 2025, mbjellje fidanësh

Specialistët e ADZM Shkodër, në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit e shkollës së mesme të Bashkuar "Ded Gjon Luli", organizuan një aktivitet sensibilizues për pyllëzimin. Gjatë këtij aktiviteti, u mbollën 50 fidanë të llojit pishë e egër në oborrin e shkollës. Qëllim i këtij aktiviteti ishte rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pyllëzimit dhe ruajtjen e mjedisit. Nxënësit, mësuesit u angazhuan për të kontribuar në përmirësimin e ambientit dhe rritjen e gjelbërimit në zonën përreth shkollës.

27 janar 2025, mjedis i gjelbër

Në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit e shkollës 9-vjeçare "Prek Gjoni", specialistët e ADZM Shkodër organizuan një aktivitet sensibilizues mbi rëndësinë e pyllëzimit, në kuadër të "Ditës së Shërbimit Pyjor". Aktiviteti përfshiu mbjelljen e 50 fidanëve pishë e egër në oborrin e shkollës, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për vlerat e pyllëzimit. Ky aktivitet pyllëzimi, i cili përfshin mbjelljen e pemëve dhe fidanëve, është një hap i rëndësishëm në pasurimin e gjelbërimit dhe mbrojtjen e natyrës. Mesazhi që u përcoll ishte: "Të gjithë bashkë mund të bëjmë një mjedis më të pasur", duke inkurajuar komunitetin shkollor të kontribuojë në krijimin e një ambienti më të gjelbër dhe të shëndetshëm.



censusi i shpendëve ujorë dimërues

pishë e egër

edukim mjedisor

aktivitet pyllëzimi

“EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



23 janar 2025, vlerat e Alpeve Shqiptare

Në shkollën 9-vjeçare “Ali Podrimja” u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët të AdZM Kukës. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me majat më të larta të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare dhe rëndësinë e këtyre maleve në ruajtjen e biodiversitetit të parkut, si dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Mesazhi i përçuar ishte ndërgjegjësimi i nxënësve mbi rëndësinë që kanë malet dhe vlerat natyrore që ato mbartin.

27 janar 2025, Dita e Shërbimit Pyjor

Në Ditën e Shërbimit Pyjor, specialistët e AdZM Kukës realizuan një prezantim në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Krumë”, ku u theksua rëndësia e shërbimit pyjor në mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore. Gjatë prezantimit, nxënësit u njohën me rolin e këtij shërbimi në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit. Mesazhi kryesor ishte theksimi i rëndësisë që ka Shërbimi Pyjor në ruajtjen e vlerave natyrore dhe përfitimet që sjell për mbrojtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit.

28 janar 2025, aktivitet mjedisor

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Shkinak”. Ata u njohën me Parkun Natyror Korab-Koritnik, vlerat që ky park ka dhe faunën e egër që ndodhet brenda tij. Nxënësit mësuan për llojet e ndryshme të kafshëve që gjenden në këtë zonë dhe rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit të këtij parku. Mesazhi kryesor i përçuar tek nxënësit ishte ndërgjegjësimi për vlerat që mbart Parku Natyror Korab-Koritnik dhe si mund të kujdesemi për to, duke promovuar mbrojtjen e tij.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



24 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në Ditën Botërore të Edukimit Mjedisor specialistët e AdZM Dibër realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 – vjeçare “Irfan Hajrullai”. Specialistët informuan nxënësit rreth rëndësisë së Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor dhe mënyrave më të thjeshta të riciklimit. Në fund, nxënësit krijuan disa mbajtëse për materialet shkollore të cilat mund të përdoren në klasë, si dhe kurora me mesazhe frymëzuese për ndërgjegjësimin e mjedisit.

27 janar 2025, rëndësia e pyjeve

Dita e Shërbimit Pyjor në Shqipëri është një ngjarje e veçantë që ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës. Kjo ditë shërben për të nderuar punën e specialistëve të shërbimit pyjor dhe për të promovuar ruajtjen e pasurive natyrore që ofrohen nga ekosistemet e pyjeve. Në këtë kuadër, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore mjaft interesante për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Demir Gashi”. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit mësuuan për rëndësinë jetike të pyjeve, si pasuri natyrore që mbrojnë biodiversitetin dhe përmirësojnë cilësinë e jetës. Nxënësit u njohën me një zonë të mbrojtur të vendit dhe kuptuan se si pyjet janë strehë për kafshët e egra dhe një burim i rëndësishëm për mjedisin tonë, duke kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit, pastrimin e ajrit dhe rregullimin e klimës.

ditë botërore

edukim mjedisor

shërbimi pyjor



26 janar 2025, orë mjedisore

Orët mjedisore luajnë një rol të rëndësishëm në shkolla, pasi ndihmojnë nxënësit të kuptojnë rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe të angazhohen për ruajtjen e mjedisit. Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një aktivitet me nxënësit e shkollës së mesme të Bashkuar "Ndoc Gjetja". Gjatë këtij aktiviteti, nxënësve iu shpjegua rëndësia e kësaj dite dhe se si ata mund të kontribuojnë me veprime të thjeshta, si mbrojtja e natyrës dhe riciklimi i produkteve të përditshme që përdoren. Nxënësit krijuan kurora me letra dhe figura, duke përcjellë mesazhe për ruajtjen e mjedisit. Mesazhi kryesor ishte rritja e ndërgjegjësimit për Ditën Botërore të Mjedisit dhe inkurajimi i nxënësve të kontribuojnë në mënyra të vogla për mbrojtjen e natyrës.

27 janar 2025, Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar

Njohja me Shërbimin Pyjor Shqiptar dhe rolin e tij në mbrojtjen e natyrës është një mundësi e shkëlqyer për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve për rëndësinë e pyjeve dhe zonave të mbrojtura. Në këtë kuadër, nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Fran Ivanaj" morën pjesë në një orë mjedisore të zhvilluar nga specialistët e AdZM Lezhë, ku mësuan për funksionin dhe historinë e shërbimit pyjor në Shqipëri. Gjatë aktivitetit, nxënësit krijuan modele pyjesh me materiale natyrore, duke zhvilluar imagjinatën e tyre. Qëllimi i aktivitetit ishte rritja e ndërgjegjësimit të nxënësit për rëndësinë e shërbimeve pyjore në mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e pasurive natyrore, duke theksuar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ekosistemet e shëndetshme.

“EDUKIMI MJEDISOR”, FIER

26



26 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Fier organizuan një aktivitet mjedisor mbi rëndësinë e kësaj dite. Aktiviteti u zhvillua në Qendrën e Vizitorëve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, ku morën pjesë nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Foto Puka" të Lushnjës. Gjatë aktivitetit, nxënësit patën mundësinë të mësojnë për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe ekologjisë. Për më tepër, ata mbollën rreth 300 fidanë pishë në plazhin e Divjakës, duke kontribuar në pasurimin dhe ruajtjen e natyrës në këtë zonë të veçantë.

“EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



15 janar 2025, mbjellje fidanësh

Specialistët e AdZM Durrës realizuan një orë mjedisore me nxënësit e klasës së gjashtë të shkollës 9-vjeçare “Qazim Zenel Tepshi”, ku diskutuan rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin e tij në shëndetin e njeriut dhe natyrës. Nxënësit u informuan për disa mënyra të thjeshta dhe efektive për të ruajtur një mjedis të pastër, si reduktimi i mbetjeve, riciklimi, përdorimi i energjisë rinovueshme dhe mbjellja e pemëve. Aktiviteti përfshiu një pyetësor ku nxënësit diskutuan ide për një të ardhme më të qëndrueshme. Grupi fitues mori një çertifikatë simbolizuese. Mesazhi i përçuar ishte se secili mund të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit me veprime të vogla, por të rëndësishme, për një planet më të pastër dhe më të gjelbër.

16 janar 2025, njohja me pishat dhe bredhat

Në shkollën 9-vjeçare “Jubë” Durrës, specialistët e AdZM Durrës, zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e klasave të gjashta dhe të shtata, e cila u nda në dy faza. Gjatë fazës së parë, përmes posterave, nxënësit u njohën me pishat dhe bredhat e zonave të mbrojtura, karakteristikat dhe rëndësinë e këtyre pemëve, si dhe kërcënimet që mund t'i dëmtojnë ato dhe periudhën më të përshtatshme për mbjelljen e tyre. Në fazën e dytë, aktiviteti vijoi me mbjelljen e fidaneve të Eukaliptit, duke kontribuar në pasurimin dhe përmirësimin e mjedisit të shkollës. Ky aktivitet ndihmoi nxënësit të kuptojnë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

26 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare “Mustafa Kaçaçi” duke theksuar rëndësinë e edukimit mjedisor për mbrojtjen e natyrës dhe burimeve natyrore.

Gjatë aktivitetit, nxënësit morën pjesë në diskutime dhe aktivitete praktike mbi tema të rëndësishme si riciklimi, mbjellja e bimëve, energjia e rinovueshme dhe menaxhimi i ujit.

Specialistët theksuan se edukimi i brezave të rinj është çelësi për një të ardhme më të pastër dhe më të shëndetshme, pasi pa angazhimin e tyre, asnjë iniciativë mjedisore nuk mund të jetë e suksesshme. Aktiviteti përfshiu diskutime dhe plotësimin e disa pyetësorëve mbi veprimet konkrete që mund të ndërmerren për ruajtjen e burimeve natyrore dhe krijimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme me mjedisin.

27 janar 2025, Dita e Shërbimit Pyjor

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Durrës organizuan një aksion mjedisor në Parkun Natyror të Qafështamës, ku nxënësit e klasës së shtatë të shkollës “Mustafa Kaçaçi” morën pjesë në mbjelljen e 1300 fidanëve pishë e egër. Ky aktivitet pati për qëllim sensibilizimin e të rinjve për rëndësinë e ruajtjes së pyjeve dhe mbrojtjen e mjedisit, duke theksuar rolin e shërbimit pyjor në pasurimin e ekosistemit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Nxënësit u njohën me rëndësinë e angazhimit të tyre në ruajtjen e natyrës dhe kontribuan drejtpërdrejt në mbjelljen e fidanëve, duke kuptuar rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit.



10 janar 2025, njohja e nxënësve me shumëllojshmërinë e fluturave

Shkolla Cikli i Ulët "Brar", në Zall-Bastar, pjesë e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit", mirëpriti specialistët e AdZM Tiranë për të organizuar një orë mjedisore. Në këtë aktivitet u përfshinë nxënës të klasës së pare, të cilët paten mundësinë të njihen me shumëllojshmërinë e fluturave që gjenden në Parkun Kombëtar Dajt.

Nxënësit mësuan për ciklin jetësor të fluturave dhe fazat e zhvillimit të tyre. Më pas, ata plotësuan në fleta këto faza dhe i dekoruan në mënyrë krijuese. Mesazhi i përçuar tek nxënësit ishte ndërgjegjësimi për rëndësinë e fluturave, duke u fokusuar në bukurinë e larmisë së ngjyrave të këtyre insekteve dhe ndikimin e tyre në mjedis. Aktiviteti i ndihmoi fëmijët të kuptonin më mirë natyrën dhe pasuritë që ofron parku.

26 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, në shkollën e Mesme të Bashkuar "Bahri Nela" në Zall-Bastar, pjesë e Parkut Kombëtar "Mali i Dajti", u zhvillua një aktivitet edukues me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për ruajtjen dhe mbrojtjen mjedisit. Ata përgatitën postera dhe u angazhuan në aktivitete krijuese me materiale të riciklueshme, duke theksuar rëndësinë e zvogëlimit të ndikimit njerëzor në natyrë. Mesazhi i aktivitetit ishte edukimi i brezave të rinj për të promovuar sjellje të qëndrueshme mjedisore.

27 janar 2025, Dita e Shërbimit Pyjor

Specialistët e AdZM Tiranë, në Ditën e Shërbimit Pyjor organizuan një orë mjedisore në shkollën 9-vjeçare "Tufinë". Aktiviteti u zhvillua me nxënësit e klasës së parë dhe të gjashtë. Ky aktivitet përfshiu veprimtari krijuese dhe edukative: nxënësit e klasës së parë realizuan vizatime duke ngjyrosur duart dhe gjethet, ndërsa nxënësit e klasës së gjashtë zhvilluan një lojë me pyetje për të zgjeruar njohuritë mbi rëndësinë e pyjeve. Në përfundim të aktivitetit, nxënësit u angazhuan në mbjelljen e disa fidanëve, duke dhënë një kontribut për shtimin e gjelbërimit dhe zbukurimin e ambientit të shkollës, si dhe duke përforcuar ndjenjën e përgjegjësisë për kujdesin ndaj mjedisit.

“EDUKIMI MJEDISOR”, ELBASAN



9 janar 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Beqir Halili” në Rrajcë, duke trajtuar temën “Flora dhe Fauna e Parkut Kombëtar ‘Shebenik’”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me larmishmërinë e florës dhe faunës, përfshirë llojet endemike të bimëve dhe kafshëve që jetojnë aty. Aktiviteti u zhvillua në formën e një bashkëbisedimi, ku nxënësit shfaqën interes duke e treguar këtë përmes pyetjeve që bënë për të mësuar më shumë rreth parkut natyror. Specialistët theksuan rëndësinë e mbrojtjes së këtyre burimeve natyrore dhe përçuan mesazhin e ruajtjes së florës dhe faunës për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

14 janar 2025, Parku Kombëtar Shebenik

Orët mjedisore janë të rëndësishme për edukimin e brezave të rinj në lidhje me ruajtjen e natyrës dhe pasurive natyrore. Një orë e tillë u zhvillua nga specialistët e AdZM Elbasan, me nxënësit e shkollës së Mesme të Bashkuar “Shefqet Dosku” në Dorëz, ku tema kryesore ishte “Fauna në Parkun Kombëtar ‘Shebenik’”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me larmishmërinë e faunës dhe si ato jetojnë në harmoni me natyrën. Aktiviteti ishte një mundësi për të sensibilizuar nxënësit mbi rëndësinë e ruajtjes së këtyre zonave natyrore dhe mbrojtjen e kafshëve. Nëpërmjet bashkëbisedimit dhe pyetjeve, ata mësuan më shumë për llojet e faunës dhe rolin që ato luajnë në ekosistemin e parkut.

Parku Kombëtar Shebenik

mbjellje fidanësh

ditë botërore

aktivitet pastrimi

zona të mbrojtura

16 janar 2025, fauna e egër

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Ibrahim Alliu" në Hotolisht, e cila ndodhet pranë Parkut Kombëtar "Shebenik". Gjatë kësaj ore, nxënësit patën mundësinë të shqyrtonin pyetje si: Si e krijojnë kafshët e egra habitatin e tyre në Parkun Kombëtar "Shebenik"? Si i përshtaten ato mjedisit dhe jetojnë në harmoni me natyrën? Përmes këtij diskutimi, ata mësuan më shumë për faunën dhe mënyrat e adaptimit të kafshëve me mjedisin e tyre. Gjatë bashkëbisedimit, nxënësit u ndërgjegjësuam për rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve dhe habitateve të tyre. Mesazhi që u përcoll ishte nevoja për t'u kujdesur për kafshët dhe për të ruajtur mjediset natyrore ku ato jetojnë.

21 janar 2025, aktivitet mjedisor

Një aksion pastrimi u realizua me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Veiz Çota" në Togëz, me qëllim sensibilizimin e të rinjve mbi rëndësinë e mbajtjes së një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm. Specialistët e AdZM Elbasan, në bashkëpunim me mësuesit dhe nxënësit, organizuan aktivitetin në ambientet e shkollës dhe zonën përreth saj. Aktiviteti nisi me një prezantim edukativ mbi rëndësinë e pastrimit dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit. Nxënësit morën pjesë në aksionin e pastrimit të ambienteve të shkollës dhe zonës përreth saj. Ky aktivitet synoi rritjen e ndërgjegjësimin të tyre për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe për angazhimin në ruajtjen e tij.

23 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në kuadër të "Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor", specialistët e AdZM Elbasan realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Librazhd-Katund". Gjatë këtij aktiviteti, tema e trajtuar ishte "Riciklimi", ku nxënësit u njohën me rëndësinë e riciklimit dhe metodat e ndarjes së mbeturinave në kategori të ndryshme: metal, letër, qelq, dhe plastikë. Aktiviteti u pasua me një demonstrim konkret të ndarjes së mbeturinave, duke theksuar impaktin negativ që ato mund të kenë në mjediset ujore dhe tokësore. Në përfundim, u realizua një pyetësor me nxënësit për të matur nivelin e njohurive të tyre mbi riciklimin.

27 janar 2025, Dita e Shërbimit Pyjor

Në kuadër të "Ditës së Shërbimit Pyjor", specialistët e AdZM Elbasan organizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Veiz Çota" në Togëz, ku realizuan një aktivitet mbjelljeje të fidanëve të llojeve të ndryshme si dushk, bredh dhe dafina. Aktiviteti nisi me një prezantim mbi rëndësinë e mbjelljes së pemëve dhe metodën e duhur për ta realizuar atë. Pas kësaj, nxënësit u angazhuan në mbjelljen e fidanëve, një aktivitet që i nxiti ata të reflektojnë mbi rëndësinë e pemëve për mjedisin dhe për jetesën tonë. Nxënësit shfaqën interes gjatë aktivitetit dhe kuptuan se mbrojtja e natyrës dhe kujdesi për pemët ndihmojnë në pastrimin e ajrit dhe krijimin e një ambienti më të shëndetshëm. Mesazhi kryesor që u përcoll ishte rëndësia e mbjelljes së pemëve dhe kujdesi për to për të siguruar një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm.

30 janar 2025, vlera natyrore

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një orë edukative me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Dilaver Nezha", ku tema kryesore ishte "Studim Habitati në Parkun Kombëtar Shebenik". Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me larmishmërinë e bimëve mjekësore që gjenden në këtë park dhe rëndësinë e tyre për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Aktiviteti pati si qëllim njohjen dhe promovimin e vlerave natyrore të këtij parku dhe përcimin e dashurisë për natyrën te brezi i ri. Prezantimi u pasua nga një bashkëbisedim me nxënësit, të cilët nëpërmjet pyetjeve, mësuan më shumë rreth florës dhe faunës së parkut duke kërkuar informacione shtesë për bimët mjekësore dhe përdorimin e tyre. Kjo orë mjedisore ishte një mundësi shume e mirë për nxënësit të zgjerorin njohuritë e tyre dhe të kuptonin rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit në zonat e mbrojtura.



26 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Në Ditën Botërore të Edukimit Mjedisor, specialistët e AdZM Berat organizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës "Thimi Tani". Gjatë kësaj ore, nxënësit zhvilluan diskutime mbi rëndësinë e kësaj dite, duke theksuar nevojën për edukimin mjedisor si një mjet kyç për promovimin e ruajtjes së mjedisit dhe biodiversitetit. Ata ndanë mendime dhe ide ndërmjet njëri-tjetrit, duke diskutuar mënyra se si mund të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit dhe në ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm.

28 janar 2025, menaxhimi i mbetjeve

Nxënësit e klasës së IV-të të shkollës "Thimi Tani" morën pjesë në një orë mjedisore të organizuar nga specialistët e AdZM Berat, në kuadër të projektit "Unë dhe Mjedi". Tema e zgjedhur për këtë projekt ishte "Mbetjet dhe problemet që shkaktojnë ato në mjedis dhe në shëndetin e njeriut". Gjatë aktivitetit, specialistët zhvilluan një orë informuese dhe motivuese, ku u shpjeguan ndikimet e mbetjeve në mjedis dhe shëndetin publik. Qëllimi i aktivitetit u arrit me sukses, pasi nxënësit morën përgjigje të detajuara për pyetjet e tyre, të cilat u trajtuan me profesionalizëm nga specialistët. Ky aktivitet ishte një mundësi e shkëlqyer për nxënësit që të kuptojnë më mirë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve.

“EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



26 janar 2025, orë mjedisore

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Edukimit Mjedisor, në shkollën 'Gjergj Pekmezi' u zhvillua një orë mjedisore nga specialistët e AdZM Korçë. Diskutimi u fokusua në rëndësinë e kësaj dite dhe ndërgjegjësimin e nxënësve për ruajtjen e natyrës. Aktiviteti synoi të theksojë nevojën për veprime konkrete në mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e përgjegjësisë qytetare ndaj natyrës.

29 janar 2025, orë mjedisore

Në shkollën "Sotir Gurra" në Korçë, nxënësit e klasave të treta morën pjesë në një orë mjedisore të organizuar nga Administrata e Zonave të Mbrojtura Korçë. Gjatë aktivitetit, ata u njohën me pemën e blirit, duke mësuar rreth rëndësisë dhe veçorive të saj. Më pas, zhvilluan një aksion mbjelljeje në oborrin e shkollës. Aktiviteti synonte të ndërgjegjësojë nxënësit për ruajtjen e mjedisit dhe rëndësinë e mbjelljes së fidanëve të rinj çdo vit, duke theksuar nevojën për të shmangur prerjen e pemëve.





26 janar 2025, Dita Botërore e Edukimit Mjedisor

Me rastin e Ditës Botërore të Edukimit Mjedisor, AdZM Gjirokastrë organizoi një orë mjedisore në shkollën "At Stath Melani". Nxënësit u njohën me rëndësinë e marrëdhënies midis njeriut dhe mjedisit, si dhe me mënyrat se si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e natyrës. U theksua se edukimi mjedisor luan një rol kyç në ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme dhe në mirëqenien e komuniteteve. Aktiviteti synoi të ndërgjegjësojë të rinjtë mbi rëndësinë e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për brezat e ardhshëm.

29 janar 2026, gjurmët e kafshëve të egra

Në kopështin "Dervicianit" në Gjirokastrë, AdZM Gjirokastrë zhvilloi një orë mjedisore me fëmijët e grupit parashkollorë, ku mësuuan si të identifikojnë gjurmët e kafshëve të egra. Aktiviteti u realizua në kuadër të rëndësisë së zonave të mbrojtura si habitat jetik për shumë lloje kafshësh. Fëmijët u njohën me disa nga gjurmët e kafshëve të egra që ishin evidentuar në terren nga specialistët e AdZM Gjirokastrë. Ky aktivitet kishte për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e fëmijëve për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës.



14 janar 2025, njohja me zonat e mbrojtura

Një orë mjedisore u zhvillua me studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit "Ismael Qemali" në Vlorë, e fokusuar në njohjen e zonave të mbrojtura, habitatet, biodiversitetin dhe peizazhet e larmishme. Specialistët e AdZM Vlorë theksuan rëndësinë e ruajtjes së zonave të mbrojtura nga dëmtimet e ndryshme dhe ndikimet negative që mund të vijnë si pasojë e veprimeve të papërgjegjshme. Aktiviteti kishte për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve për rëndësinë e mbrojtjes së këtyre zonave të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekosistemeve të shëndetshme.

22 janar 2025, folezimi i breshkave detare

Specialistët e AdZM Vlorë zhvilluan një orë mjedisore me studentët e masterit të Universitetit "Ismael Qemali" në Vlorë, e fokusuar në monitorimin e folezimit të breshkave detare dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre. Diskutimi përqendrohej te kërcënimet që këto kafshë kanë, veçanërisht ato të shkaktuara nga zhvillimi urban dhe ndikimet e tjera negative. Specialistët theksuan rëndësinë e mbrojtjes së habitatit të breshkave detare dhe rolin e monitorimit të vazhdueshëm për sigurimin e mbijetesës së tyre.